



Datë: 29.04.2026

A.nr.1916/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Merlinda Ramaj si procesmbajtëse, duke vepruar në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1916/2025, të datës 19.11.2025, të parashtruar nga ankuesja Z.M-Sh, kundër organit të punësimit: Thesari i Kosovës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin, 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 29.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1916/2025, e datës 19.11.2025, e parashtruara nga ankuesja Z.M-Sh.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile Z.M-Sh (*referuar tutje vetëm ankuesja*), më datë 19.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës për kompensimin e diferencës në pagë, për pozitën e mbajtur si Udhëheqëse e Sektorit të Trajnimeve në Divizionin e SIMFK-së për periudhën nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/196 për Pagat në Sektorin Publik deri me datë 24.10.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 7434/2025, të datës 19.11.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës, të datës 19.11.2025; Shkresa për nënshkrimin e vendimit Nr.09/2021 dhe 10/2021, e datës 08.02.2021; Vendim për transferim të përkohshëm me numër Nr.10/2020, i datës 08.02.2021; Vendim për transferim të përkohshëm me numër Nr.08/2024 me datës 12.01.2024; E-mail i datës 15.01.2024; Akt emërimi i Z.M me datë 20.01.2018; Plotësim/Ndryshim i akt emërimit i datës 01.02.2022; E-mail i datës 17.03.2023; Kërkesë për diferencë në pagë me numër protokoli Nr.9537, i datës 27.10.2025; E-mail i datës 30.10.2025; E-mail i datës 29.10.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses Z.M-SH; E-mail i datës 28.10.2022; Raport javor 24.10.2022 deri më 28.10.2022, i datës 28.10.2022; E-mail i datës 28.10.2022; E-mail i datës 23.03.2023; E-mail i datës 16.03.2023; E-mail i datës 08.03.2023; E-mail i datës 29.03.2023; E-mail i datës 11.09.2024; E-mail i datës 17.12.2024; E-mail i datës 23.09.2024; E-mail i datës 22.10.2024; E-mail i datës 19.12.2024; E-mail i datës 22.01.2026; Lista e pagave për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025; E-mail i datës 15.01.2026; Rregullore (QRK) Nr.06/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Thesarin e Kosovës; Memorandum Bashkëpunimi për bartjen e Divizionit të Sistemit të Pagave nga Ministria e Administratës Publike në Ministrinë e Financave me numër protokoli Nr.02/07, i datës 14.10.2015; Përshkrimi i detyrave të punës; Akt emërimi i B.S, i datës 01.08.2013; Konkurs i Brendshëm me numër reference 01-2015 DTH, i datës 21.11.2015; Akt emërimi i B.S, i datës 10.12.2015; Vendim i KPMSHCK-së me A.nr.493/2025 dhe me numër protokoli Nr.3920/2025, e datës 10.06.2025; E-mail i datës 20.10.2025; Kartela e nëpunësit e datës 15.01.2026;

Gjedhja e Fakteve

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se:

- ankuesja është e punësuar në Thesarin e Kosovës, dhe se e njëjta sipas akt emërimit me numër të datës 20.01.2018, ushtron pozitën e punës “Zyrtare e të Hyrave Financiare”, në Sektorin e Operimeve.
- Me Vendimin Nr.10/2021, të datës 08.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, ankuesja është transferuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Trajnime.
- Me datë 01.02.2022, ankueses i është bërë plotësimi dhe ndryshimi i aktit të emërimit, ashtu që pozita e ankueses është klasifikuar në klasën profesional 1 me koeficient 8 të pagës sipas sistemit të vjetër të pagave.
- Me vendimin Nr.08/2024, të datës 12.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, ankuesja serish ishte transferuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqëses së Sektorit për Trajnime në Divizionin e SIMFK-së.
- Më Vendimin Nr.17/2025, të datës 24.04.2025, të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, ankuesja është transferuar në mënyrë të përhershëm në pozitën Zyrtare e Lartë për Trajnim dhe Zhvillim në Divizionin e SIMFK-së.

- Më datë 3.10.2025, ankuesja ka parashtruar kërkesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës për kompensimin e diferencës në pagë, për pozitën e mbajtur si Udhëheqëse e Sektorit të trajnimeve në Divizionin e SIMF-së, nga data 05.01.2023 deri më datën 24.10.2024, ndërsa, Menaxherja e Personelit të Thesarit të Kosovës, më datë 30.10.2025, përmes përgjigjes në kërkesë në e-mailin zyrtar me përmbajtjen “ *Si Burime Njerëzore , ju kam sqaruar kompetencat ligjore që na përkasin lidhur me kërkesën tuaj dhe, si rezultat këtë çështje e konsideroj të mbyllur*”

Pretendimet ankimore

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për realizimin e kompensimit e diferencës në pagë, për pozitën e mbajtur si Udhëheqëse e Sektorit të Trajnimeve në Divizionin e SIMFK-së. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, dhe të detyroj organin e punësimit që të realizoj kompensimin për përdhën 05.01.2023 deri 24.10.2024.

Vlerësimi i Kolegjit

Duke qenë së pala ankuese të drejtën materiale të pretenduar e mbështet në faktin së e njëjta ka ushtruar detyrën e Udhëheqëses së Sektorit të Trajnimeve në Divizionin e SIMF-së për periudhën nga 08.02.2021 deri më datë 24.10.2024, Kolegji nga analizimi i provave materiale të çështjes ka konstatuar së ankuesja fillimisht më Vendimin Nr.10/2020 të datës 08.02.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës ishte transferuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqëses së Sektorit të Trajnimeve në Divizionin e SIMFK, ashtu që, sipas pikës II të këtij vendimi, transferimi bazohej në nenin 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06 L-114 për Zyrtarët Publikë dhe së ky transferim nuk reflekton në ndryshim të Aktit të Emërimit të ankuses, ndërsa, më Vendimin Nr. 08/2024, të datës 12.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës ankuesja serish ishte transferuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqëses së Sektorit të Trajnimeve në Divizionin e SIMFK-së, ashtu që, caktimi bazohej në nenin 63, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërsa, ankuesja sipas thënieve në ankesë këtë pozitë e ka ushtruar deri me datë 23.10.2024.

Kolegji në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore thekson faktin së Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka qenë i aplikueshëm nga data 09.07.2020 deri me 25.09.2023, dhe së i njëjti me nenin 52 ka përcaktuar se: *Transferimi i përkohshëm 1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës....*” e në kuptim të këtij përcaktimi ligjor rrjedhë fakti se meqenëse ankuesja sipas Vendimit Nr.10/2020 të datës 08.02.2020, ishte transferuar përkohësisht në pozitë e Udhëheqëses së Sektorit të Trajnime në Divizionin e SIMFK-së mbi bazën e nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, atëherë, rezulton së ankuesja ka ushtruar këtë pozita vetëm nga data 08.02.2021 deri me 08.08.2021, pra vetëm 6 muaj, sepse, sipas dispozitave ligjore si më sipër, transferimi i përkohshëm

për nevoja institucionale mund të bëhej vetëm në kohëzgjatje deri 6 muaj dhe atë brenda dy viteve, kështu që, çdo periudhë tjetër pas 6 muajve konsiderohet në papajtueshmëri me dispozitat ligjore, ndërsa, prej datës 08.08.2021 e deri me datë 12.01.2024, ankuesja nuk posedon ndonjë akt administrativ tjetër që dëshmon autorizimin e saj për ushtrim të detyrës së Udhëheqëses së Sektorit të Trajnime në Divizionin e SIMFK-së, andaj, edhe Kolegji nuk mund ta trajtoj bazueshmërinë e pretendimit ankimor për kompensim për periudhën nga data 01.05.2023 deri 12.01.2024, pasi që siç u konstatua ankuesja nuk ka arrit të argumentoj ushtrimin faktik të pozitës në fjalë nga data 08.08.2021 deri 11.01.2024.

Ndërsa, lidhur me periudhën nga data 12.01.2024 deri 23.10.2024, Kolegji ve në dukje faktin e pa kontestuar së ankuesja përmes Vendimit Nr.08/2024, të datës 12.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, e mbi bazën e nenit 63, paragrafi ,1 nënpika 1.1 dhe 1.2 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ishte transferuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Trajnimeve në Divizionin e SIMFK-së, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit ky transferim ka qenë në kundërshtime të plotë me nenin 63 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, sepse, transferimi i përkohshëm lejohet vetëm nga/në kategori të njëjtë, ndërsa, në rastin konkret ankuesja nga kategori profesionale si Zyrtare e Lartë e të Hyrave ishte transferuar në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Trajnimit, e që në kuptim të legjislacionit fuqi sektori konsiderohet si njësi ekuivalente me divizionin, sqarime tashme të dhëna më Vendimin e Këshillit A.nr.493/2025, të datës 10.10.2025, andaj, dhe mbi këtë rrethana, Kolegji erdhi në përfundimin së nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet për kompensimin material si në ankesë.

Rrjedhimisht, në kontekst të konstatimit si më sipër, Kolegji ju referua nenit 63 të Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikëi cili ka përcaktuar se: *Transferimi i përkohshëm 1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve; 1....2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër, që punëson shërbyes civil.3. Transferimi i përkohshëm i nëpunëses/it civil, është vendim i drejtueses/it më të lartë të institucionit dhe mund të refuzohet nga shërbyesja/ i civil në këto raste: 3.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë së njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil. 4. Nëpunësja/i civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, i cili është më i largët se sa vendi i saj i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësen/in. 6. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësja/i civil kthehet në pozitën e mëparshme...*

Kështu që thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të LPPA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1916/2025

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Z.M-Sh;
- Thesarit të Kosovës: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.